Mustaf Jonuzi Kica Ecc.Dipl.

Fisi KICA-J
në Pollog

Monografi

Tetovë-2021

- HISTORIOGRAFIA

Nga “Visaret e Kombit , Volumi VII (f.13 dhe 14)” dhe “Kanuni i Lekë Dukagjinit , varianti i Pukës (f.180 dhe f.181) “Aleksander Kolonja (Aleksandër Koloja) rreth viteve 1300 nga malet e Pindit vjen në Kabash në Bicaj , i martuar me një vajzë Gazullore , lindin 4 djem.



Fisi KICA-J / Kicë

Shenime të përgjithëshme.

Fisi **Kica-j/Kicë** , janë njerëz të racës së bardhë Europeane janë ; familjar , intelegjent , të shkolluar , bujar , punëtor , të ndershëm , respektojnë dhe respektohen , profesionist , intelektual , bujk , blegtor , njerëz pozitivë , dhe me shumë tipare tjera të mira , në kohët e vështira e kan treguar veten duke ndihmuar të tjerët pamvarësisht nga vijnë edhe si luftëtar edhe si humanist kanë dhënë kontributin e tyre në shoqëritë ku gravitojnë , kudo që jetojnë respektojnë Ligjin dhe shtetin ku jetojnë.

Fisi **Kica-j/Kicë** , viset ku jetojnë Kicët janë viset ku ka luftuar Skenderbeu dhe kanë qenë pjesmarës në ato lufta si ushtar dhe si oficerë të lartë , me vdekjen e Skenderbeut ngelin në këto troje , kanë besime fetare të ndryshme në të vërtetë sot i gjeni si pjestarë të feve: **Islame , Katolike , Ortodokse** .

Fisi **Kica-j/Kicë** , zakonisht janë shpërndarë në gjithë Botën , jetojnë kryesishtë në **Europe** në **Amerikë** , **Australi** zakonisht jetojnë në vendet ku jeton raca e bardhë Europeane , sipas studimeve dhe migrimeve të popullatave besohet se janë të njejtit pamvarësisht se jetojnë në kontinente te ndryshme.

Në **Europë**,jane shpërdarë pothuaj se në çdo shtet European por në kohën që shkruaj këto shënime si qytetarë autokton jetojnë në këto shtete : Shqipëri , Kosovë , Maqedoninë e veriut , Poloni , Cheki , Slovaki , Irlandë , Angli , Gjermani , Francë dhe të shpërndare edhe në shtete tjera .

Në **Shqipëri** zakonisht janë shpërndarë në gjithë teritorin e sotëm të shtetit Shqiptar , shumica janë të besimit Islam por ka edhe te besimit Katolik dhe Ortodoks , viset ku kanë përqëndrim më të madhë janë në qytetetet dhe komunat : **Dibër** (Ushtelenca) , **Bulqiza**(Fushë) ,**Mat**(Prell,Zmaç,Zall Prell), **Fieri** (Alibeas , Grecali,Hodaj,Rrungaj,Daullas) , **Tirana** , **Durrësi(**Rrushkull) , **Lushnja** (Kolonjë,Pirrë,Rrapëz Fshat,Bubullimë), **Kavaja**(Greth) , **Berati** (Moravë), **Krujë**(Gramëz) etj . *'Shenime të siguruarara nga miku dhe Kica jonë:Ramazan Kica'*

Në **Kosovë** zakonisht janë shpërndarë në gjithë teritorin e sotëm të shtetit por autokton janë në teritorin në afërsi të kufirit me Shqipërinë , Dukagjin , shumica janë të besimit Islam edhe pse jetojnë pothuajse në çdo qytet të shtetit të Kosovës , po viset ku kanë përqëndrim më të madhë janë në qytetet dhe komunat : Peja , Prizreni , Suharekë-Therandë (fshati Grejkoc) etj.

Në **Poloni** janë shpërngulur nga Kosova respektivisht nga qyteti i Pejës kah vitet 1600 , në vitet 1600-1700 fisi Kica kanë qenë kriptokrishterë diku kanë qenë Katolik e diku Ortodoks , në ato vite fisi Kica parcialisht në disa vise fillon edhe të pranon fenë Islame fillimisht si Bektashinj , ashtu që pjesa e fisit Kica që nuk kanë pranuar të ndryshojnë fe shpërngulen për brendi të Europës siq është rasti me pjestarët e fisit Kica në Poloni, atje zakonisht janë përqëndruar në 8 regjione (warmińsko-mazurskie , dolnośląskie, małopolskie..etj) në **Kraków** (Tarnów , Katowice ,..) dhe nga atje edhe ne shtetet përeth dhe në Amerikë , në Poloni janë pjestar të fesë Katolike . Këtë shënim e konfirmon edhe *' miku dhe Kica jonë:Ramazan Kica'*

Në **Amerikë** janë shpërngulur nga Europa gjatë luftrave që kanë ndodhur në Europe , zakonisht përmes porteve detare sipas një shkrimi që unë e kam has ka shumë pjestar nga fisi Kica që shperngulen për në Amerikë përmes portit të Hamburgut dhe porteve tjera dhe sipas analizave ata janë pjesë e fisit Kica nga Polonia , edhe në Amerikë Kicat janë njerëz të ndershëm , profesionist që ushtrojnë biznese të ndryshme , zakonisht në Amerikë janë pjestar të fesë katolike .

Fisi KICA / Kicët në Maqedoninë e veriut

Fisi Kica/Kicë , në bazë të të dhënave që disponoj deri në këtë moment në Republikën e Maqedonisë së veriut jetojnë si autokton (sepse kufijtë e sotëm shumë vonë vihen) edhe ate në këto qytete dhe fshatra: Dibër , Strugë (Veleshta,*Dollogozhda*), Resnje , Gostivar (*Gjurgjevisht , Negotine , Dobridoll, Senokos , Debresh, Çegran*) , Tetovë (*Kamjan , Veshallë , Reçicë e vogël , Teqe , Drenovec*) dhe në Shkup , ish sistemet duke u munduar që të humbin lashtësinë e popullatës autoktone edhe të Kicave/Kicëve u ndryshojnë mbiembrat duke i detyruar që të marin si mbiemër emrat e gjyshëve dhe stërgjyshëve (bile diku duke u shtuar edhe prapashtesen viç , por kjo nuk e humbi identitetin sepse çdoherë thireshin se ne jemi pjestar të fisit Kica/Kicë.

Fisi Kica/Kicë , ne fushën e Pollogut (***Fushëgropa e Pollogut*** *është fushëgropë e ulët, dhe gjendet në 380–550 m mbi nivelin e detit. Fushëgropa e Pollogut shtrihet midis maleve të Sharrit dhe të malit të thatë të Shkupit. Ajo ka shtrirje gati meridionale dhe është e gjatë 44 km dhe e gjerë 7 km(perëndim –lindje), me një sipërfaqe prej 250 km2*) , të gjithë Kicët që jetojnë në cilindo vendbanim të fushës së pollogut kanë qenë banor të dy fshatrave të malit Sharr : Gjurgjevisht dhe Veshallë.

Sipas dëshmitarit të gjallë të Kica-ve/Kicë-ve të Kamjanit Haxhi **Xhafer Kadri Jonuzi** i lindur në Kamjan i cili tani është 95 vjeçar thotë se ka ndëgjuar nga pleqët e familjes sonë se : " Kicët në Gjurgjevisht të Gostivarit dhe Veshallës disa shekuj më parë vijna nga rrethi i Çajës së Shqipërisë " , e cila dëshmi përputhet edhe me shënimet që jep zotëri **Ramazan Kica** nga Durrësi i cili shkruan si vijon:

"Siç kam shpjeguar dhe më herët, Kicët, që jetonin në Kabash të Pukës që në mezin e viteve 1300, si vazhdues të drejtpërdrejtë të Aleksandër Kolonjarit (Aleksandrit nga Kolonja, në jug të Korçës) i njohur si Lekë Koloja (Lekë Kolonja), lëvizën nga Puka drejt Pejës Kosovë, ndoshta në shekullin XVI.

Me sa arsyetoj unë, tre degë të fisit Kica (të Pejës Kosovë), diku në vitet 1700 u larguan (kryesisht për të ruajtur fenë kristiane të etërve) nga Peja drejt atdheut amë:

Një degë (që po e quaj – e para) u vendos në Grykë-Çajë (mes Kukësit dhe Dibrës), nga e cila dolën Kicët e pellgut të Strugës në Maqedoninë e Veriut, të rrethinave në afërsi të fushës së Pollogut në Maqedoninë e Veriut; si dhe ata të Ushtelencës Dibër të Shqipërisë."

Nga kto dëshmi të lartëpërmendura shihet se ; shperngulja se nga vijnë Kicët që sot janë jashtë kufijve adminsitartiv Shqiptar , sepse në kohën kur kanë lëvizur nuk kan egzistuar kufijtë administrativ dhe pikat kufitare.

ashtu që pjestarët e fisi Kica/Kicë kur kanë lëvizur në trojet tjera kanë lëvizur bashkë me Pasurine/Bagëtinë që kanë poseduar , me atë Pasurine/Bagëtinë kanë blerë tokat dhe pronat ku kanë jetuar.

Fisi KICA / Kicët në Pollog

Fisi Kica/Kicë në Pollog zakonisht vjen nga dy fshatrat malorë , fshati **Gjurgjevisht** dhe fshati **Veshallë** . Sot pothuajse ne keto fshatra nuk ka më Kicë , sepse janë shpërngulur në fushën e Pollogut (Tetovë,Gostivar e rrethinë) , por kanë akoma pasuri si shtëpi dhe prona tjera dhe nuk i kanë shitur , Kicë në Tetovë ka edhe nga Struga që jetojnë këtu.

Sot pjestarët e fisit Kica i gjenë të shkolluar , të punësuar në institucione të ndryshme shtetërore , i gjenë si biznesmen të suksesshëm , i gjenë të shpërndarë në gjithë Europën duke punuar në profesione të ndryshme dhe të integruar në vendet ku jetojnë dhe punojnë .

Veshalla ; Sipas informatave të mara nga pjestari i fisti tonë zotëri **Halil Aliu-Kica** njeri i ngritur intelektualisht – pensionist zviceran që tani jeton në Tetovë tregon se : Fisi Kica/Kicë në Veshallë janë diku 10 shtëpi , për momentin pothuajse të gjithë kanë prona në Tetovë dhe jetojnë në lagje të ndryshme të Tetovës .

Gjurgjevishti ; Sipas një dokumenti osman nga viti 1835 i cili tregon rregjistrimin e popullatës në atë vit figurojnë 22 pjestarë meshkuj në Gjurgjevisht , sipas këtij dokumenti figuron se ne jemi autokton në atë fshat në vitet 1700 e më herët , shumë pjestar të fisit tonë edhe pse janë shpërngulur në fushëgropën e Pollogut me vete kanë shënimet e brezave dhe dijnë sakt prejardhjen. Këtu do mundohemi që të paraqesim drurin familjar sipas gjenarateve dhe viseve ku tani jetojnë , pasi edhe vetë unë jam pjestar i familjes së parë nga fisit Kica nga Gjurgjevishti që shpërngulen në Kamjan.

Fillimisht ka vitet 1900 një pjesë e familjes vendos të shpërngulet nga Gjurgjevishti por pa ndonje cak të paracaktuar se ku , ashtu që fillimisht dalin në rajonin e malit të thatë bashkë me bagëtinë sipas gojëdhënave në fshatin Zhelinë aty qendrojnë shumë shkurt pasi nuk u përshtatej vendi ashtu që kalojnë në fshatin Shemshovë aty qëndrojn diku 3 vite dhe gjatë qëndrimit në atë fshat pasi kanë pas me vete edhe dhen , blejnë një bjeshkë në malin Sharr që edhe sot e kësaj dite quhet Bjeshka e Kicës ose mali i Kicës. Fshati Shemshovë ka pasur shumë tokën e lagur ashtu që vendosin përsëri të levizin nga atje duke bërë pazar një pronë para Gjimnazit të Tetovës bile thuhet se këstin e parë e kanë paguar , prishet pazari pasi në familje ndodhë një vdekje , e vrasin djalin Kadriun në Selanik në Greqinë e sodit , ka qenë duke ardhur me para nga Stambolli gjithashtu edhe e plaçkisin . Ashtu që me mjetet e ngelura që kanë pasur blejnë pronë në fshatin Kamjan.

Pjestarët që kan lëvizur në atë kohë nga Gjurgjevishti janë kjo degë e fisit:

Fisi Kica/Kicë që shpërngulet nga Gjurgjevishti në Kamjan

Legjenda:
^-Pa trashigimtar
~-Vetëm vajza
*- Ne Turqi
**-Te biresuar nga Vajza



Rregjistrimi i popullates gjatë sundimit osman viti 1835

Sipas këtij dokumenti edhe pse i koklavitur shihet se ka vitet 1700 ne Gjurgjevisht janë 2 vllezër të fisit Kica (Tahir Kica dhe Abaz Kica) dhe që atëherë kanë pasur mbiemrin KICA , e që në fakt kanë qenë para ardhësit tanë , në vazhdim keni dokumentin i përkthyer në gjuhën Maqedone.



24.

125. Тахир Кича?, син на Куртиш, со брада, 95 години, починал на 5 јули 1833 година.

126. Син му Куртиш, со мустаќи, 55 години.

127. Другиот син, Рамазан, со мустаќи, 34 години.

128. Син му на Куртиш, Абдулхалим, 16 години.

129. Другиот син, Абдулах, 12 години.

130. Другиот, Муртези, 10 години, во 1835 година ќе биде полнолетен.

131. Другиот син (на Куртиш), Ариф, 6 години.

132. Абдулкерим Кича, син на Фејзулах, со мустаќи, 40 години.

25.

133. Абас Кича, син на Бехрам, со мустаќи, 47 години.

134. Син му Алејман, 5 години.

- На 21 февруари 1834 година се родил другиот син, Бехрам.

135. Брат му Хасан, со мустаќи, 40 години.

136. Другиот син, Хајрулах, со мустаќи, 30 години.

137. Другиот, Сејфулах, инвалид, со млади мустаќи, 25 години.

138. Внук му Ибиш Кича, син на Кадри, со мустаќи, 47 години.

139. Син му на Ибиш, Нуман, 30 години.

140. Другиот син, Ислам, 11 години, во 1834 година ќе биде полнолетен.

141. Другиот, Јонус, 5 години.

Për fund

Edhe pse kanë ngelë plot shënime të pabotuara , besoj se këto shënime janë të mjaftueshme që çdo pjestarë i fisit tonë në fushëgropën e Pollogut ta gjenë drurin familjar .

Falemederim i posaçëm për të gjithë pjestarët e fisit tonë , që më ndihmuan në përpilimin e kësaj monografie familjare në fushëgropën e Pollogut.

Kërkoj ndjesë për gabimet drejtëshkrimore , si primare kam pasur gjenezën tonë e jo drejtëshkrimin.

Respekt pafund.

Mustaf Jonuzi Kica